



Në bazë të nenit 110 dhe nenit 163 të Ligjit për arsim të lartë, neni 321 i Statutit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup dhe Regullores për kushtet e posaqme dhe procedurës për përzgjedhje në thirjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe thirjet në bashkëpunëtorë në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, Këshilli mësimor - shkencor i Fakultetit të Shkencave Sociale pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, në mbledhjen e regullt të mbajtur me 17.03.2021 me kërkesë për angazhimin e një (1) demonstratori në lëmi të përcaktuar i propozuan Universitetit të shpalle këtë:

### KONKURS INTERN

Për angazhimin e një demonstratori në Fakultetin e Shkencave Sociale pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, për vitin akademik 2020/2021 edhe atë:

1. Për Fakultetin e Shkencave Sociale 1 (një) përmbaues edhe atë:

a) për programin studimor Media dhe komunikim ndëkulturore ----- 1 (një) përmbaues

Për demonstratorë mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet e përgjithshme sipas Ligjit për arsim të lartë dhe është student në ciklin e dytë ose të tretë të studimeve në programin adekuat studimor.

Kriteriumet për notimin e kandidatëve është siç vijon:

- mesatarja e përfundimit të studimeve deridiplomike (40% nga numri i përgjithshëm i poenave)
- mesatarja nga lëndët e domosdoshme të programit studimor në të cilin kandidati ka kryer studimet deridiplomike (50% nga numri i përgjithshëm i poenave)
- 10% nga intervista (notë nga kualiteti arsimor profesional të cilin do ta mbulojë)
- Përparësi kanë kandidatët të cilët kanë kryer studimet në universitetete të ranguar më lartë. (përlllogaritet faktori i rëndësisë përkatësisht koeficienti sipas rangimit të universitetit)

Që të zgjidhet kandidati duhet ti plotësojë kriteriumet minimale të parapara në Ligjin për arsim të lartë, Regulloren për kushtet e posaqme dhe procedurës për përzgjedhje në thirjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe thirjet në bashkëpunëtorë në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup si dhe Statutit i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup.

Demonstratori do të angazhohet minimum dy (2), por jo më shumë se në tre (3) lëndë, përkatësisht së paku gjashtë (6), deri maksimum dhjetë (10) orë në javë. Për angazhim të plotë maksimal demonstratorit i takon kompenzim në shumë maksimale prej 8.000 denarëve në muaj.

Demonstratorët do të zgjidhen pas shpaljes së konkursit intern, për vitin akademik 2020/2021.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Fletëparaqitje
- Biografi të shkurtë CV (me kontakt telefon dhe e-mail adresë)
- Dëshmi se është student i ciklit të dytë ose tretë të studimeve në programin adekuat ose se është i lajmëruar.
- Dëshmi se e ka të kryer ciklin e parë të studimeve sipas EKTS me 240 EKTS kredi me mesatare në minimum 8,00.
- Vërtetim për provimet e dhëna në ciklin e parë të studimeve
- Vërtetim për njohjen e gjuhës Maqedone dhe Shqipe nëse studimet i ka të kryera në gjuhë tjetër.

Dokumentet duhet të dorëzohen në arkivin e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, rruga Mirçe Acev nr.4 kati i 7-të, Shkup.

Me dorëzimin e fletëparaqitjes kandidatët për demonstrator janë dakord për tu regjistruar në bazën e kandidatëve për demonstrator në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup.

Dorëzimi i dokumenteve është së fundi me 31.03.2021.

Me respekt,

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup